

Numri i lëndës: 2020:127956

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05441908

C.nr. 899/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Alush Sinani, dhe bashkëpunëtoren profesionale Lumturije Fetahu, në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve "BKS", me seli në Prishtinë Rr, "Lidhja e Pejës" Magj, Prishtinë-FushëKosovë pa nr, kundër të paditurit E.R.nga V. rruga „Brigada 173”, me objekt kontesti rimbursim i dënimit material dhe jo material, vlera e kontestit 1,581.00 €, jashtë seance gjyqësore, më datën 11.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË PADËGJUESHMËRISË/MOSBINDJES

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve "BKS" dhe DETYROHET i padituri E.R., që në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jo material, t'ia paguaj paditëses paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve "BKS" shumën e përgjithshme prej prej 1,581.00 €, me kamatën ligjore prej 8% në vit, nga data 02.10.2020, si datë e ushtrimit të padisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II.. DETYROHET i padituri që paditëses t'ia paguaj shpenzimet gjyqësore në emër të tarifës gjyqësore në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve "BKS", në këtë gjykatë më datën 02.10.2020, ka paraqitur padi kundër të paditurit E.R.nga V. , për rimbursimin e dëmit të paguar në shumë prej 1,581.00 € me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e pagesë së dëmit, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm si dhe i ka kërkuar shpenzimet gjyqësore. Sipas pretendimeve të paditëses, i padituri me dt. 16.01.2019 rreth orës 09:30 min në Viti ka shkaktuar aksident trafiku me Automjetin VW, me targa të regjistrimit 06-669-CE,deri te aksidenti ka ardhur kur automjeti "A" të cilin e drejtonte Eduard Rexhepi, i cili nga pakujdesia i shkakton dëm të dëmtuarit Ariane Shabani, automjeti i cili ishte shkaktar i këtij aksidenti në momentin e shkaktimit të tij ka qenë pa mbulesë siguruse, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit prej dates 26.12.2018, ndersa e damtuara në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë me policë të sigurimit dhe me mbulesë siguruse deri më datën 30.07.2019. Në bazë të kërkesës për kompensimin e dëmit material dhe jo material të parashtruar nga ana e të dëmtuares A.S., paditësja paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve "BKS", të dëmtuares i kompensoi dëmin në shumën e përgjithshme në vlerë prej 1,581.00 euro. Për të mbështetur pretendimet si në padi, paditësja si prova materiale i ka propozuar gjykatës që të administrohen: Ujdia jashtëgjyqësore per kompenzimin e damit material ne automjet, e dates

05.02.2019, e lidhur në mes Byroja Kosovare e Sigurimeve "BKS" në Prishtinë dhe A.S.si e dëmtuar, Ujdia jashtëgjyqësore kompenzimin e damit material dhe jomaterial (lendime) e dates 27.02.2019, e lidhur në mes Byroja Kosovare e Sigurimeve "BKS" në Prishtinë dhe X.H.i autorizuari i A.S.si e dëmtuar Raporti i aksidentit i lëshuar nga PK, nr. 2019-CG-021, i dates 16.01.2019, Konfirmimi i polices sigurimit, leshuar me datë 18.01.2019, Deshmia e urdhertrasferit të mjeteve financiare në emër të Ariane Shabani, e leshuar nga Banka Ekonomike me date 11.02.2019. Deshmia e urdhertrasferit të mjeteve financiare në emër të X.H.i autorizuari i A.S.si e dëmtuar, e leshuar nga Banka Ekonomike me date 03.04.2019.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin C.nr.899/2020, me date 24.05.2023 të cilin i padituri e ka pranuar me dt.25.05.2023, e cila datë është konfirmuar përmes fletëkthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë i njëjti nëse nuk paraqesin përgjigje në padi brenda afatit ligjor, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes në disfavor të tij.

I padituri, pavarësisht se e ka pranuar personalisht aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150, par. 1, pikat a), b) dhe c) të LPK-së, në të cilën dispozitë shprehimisht parashihet se "Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht."

Gjykata nga provat që i janë bashkangjitur padisë; Ujdia jashtëgjyqësore për kompenzimin e damit material në automjet, e dates 05.02.2019, e lidhur në mes Byroja Kosovare e Sigurimeve "BKS" në Prishtinë dhe A.S.si e dëmtuar, Ujdia jashtëgjyqësore kompenzimin e damit material dhe jomaterial (lendime) e dates 27.02.2019, e lidhur në mes Byroja Kosovare e Sigurimeve "BKS" në Prishtinë dhe X.H.i autorizuari i A.S.si e dëmtuar Raporti i aksidentit i lëshuar nga PK, nr. 2019-CG-021, i dates 16.01.2019, Konfirmimi i polices sigurimit, leshuar me datë 18.01.2019, Deshmia e urdhertrasferit të mjeteve financiare në emër të Ariane Shabani, e leshuar nga Banka Ekonomike me date 11.02.2019. Deshmia e urdhertrasferit të mjeteve financiare në emër të X.H.i autorizuari i A.S.si e dëmtuar, e leshuar nga Banka Ekonomike me date 03.04.2019, ka vertetur se damtuara Ariane Shabani, është kompensuar në shumën e përgjithëshme prej 1,581.00 euro, kështu që Byroja Kosovare e Sigurimeve "BKS", pastaj i është drejtuar me kërkesë për regres shkaktarit së aksidentit, tani të paditurit me kërkesë për pagesën e rimbursimit të dëmit, pasi që i njëjti në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë

duke drejtuar automjetin e tij pa mbulesë siguruse përkatsisht me policë sigurimi me afat të skaduar.

Gjykata në kuptim të dispozitave të cekura ligjore nga neni 150 i LPK-së dhe në lidhje me dispozitat e neni 14 par.1, nën par.1.2 dhe 4 dhe neni 18 para, 4, të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ku parashihet se: “Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronar i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësise, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja dhe para.4 ku parshihet se Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat, e në rastin konkret automjeti shkaktar i aksidentit në momentin e ndodhjes së aksidentit ka qenë pa mbulesë sigurimi, i njëjti e ka drejtuar automjetin e tij pa policë sigurimi të vlefshme dhe adekuate, kështu që tani paditësja - Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat.ashtu siq parashihet në nenin 18 paragrafi 4. të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Meqenëse i padituri në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë sigurimi në bazë të neni 18 paragrafi 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, i dëmtuari ka të drejtë regresi për dëmin e shkaktuar nga personi përgjegjës, në këtë rast nga i padituri për shumën e paguar palës së dëmtuar, andaj nga këto arsye gjykata e aprovoj kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar dhe vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kamatëvonesa është gjykuar në bazë të neni 382 të LMD-së, kurse rrjedha e kamatës është përcaktuar nga data 02.10.2020, si datë e ushtrimit të padisë në gjykatë.

Në nenin 382 të LMD-së është përcaktuar se ,, 1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës konform neni 452.1 të LPK-së, duke e detyruar të paditurin, që paditëses t’ia kompenzoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 30.00€, për taksë gjyqësore të paguar, në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit të dhunshëm ligjor.

Nga të lartëcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:127956, 11.03.2024
C. nr.899/2020

Gj y q t a r i
Alush Sinani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimet të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate